REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

Nr.1941/13 prot.

B.Curri, me 28.5.2025

PROJEKT VENDIM

**Nr._____Date _____. ____.2025**

**PËR**

**DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË OBJEKTIT "AGJENCIA KOJ" E LLOJIT OBJEKT+TRUALL ME SIPËRFAQE 557 M² NDËRTESË DHE 720 M² TRUALL , NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË BASHKINË TROPOJË , PËR ADAPTIMIN SI QENDËR PËR KONTROLLIN TEKNIK TË AUTOMJETEVE RRUGORE**

Këshilli i Bashkisë Tropojë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e tij të datës ____. ____. 2025, mbështetur në nenin 8 pika 2 ; nenit 9 pika 1; nënpika 1.2 shkronja "a" , nenit 54 shkronja "e" të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"; neni 7 , shkronja "ç" dhe "dh"; neni 23 pika 28 ; neni 15 pika 1.2.2; neni 23 pika 4 të ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar) ; Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me VKB nr.95 datë 27.11.2017 dhe me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2 , datë 09.12.2017; nenit 15 të Ligjit nr.8743 dt 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme Shtetërore" (i ndryshuar) , Këshilli Bashkiak Tropojë pas diskutimeve :

V E N D O S I

1. **Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të objektit "Agjencia Koj" e llojit objekt+truall me sipërfaqe 557 m2 ndërtesë dhe 720 m2 truall , nga Ministria e Bbrojtjes në Bashkinë Tropojë , për adaptimin si qendër për kontrollin teknik të automjeteve rrugore**

   Prona që jepet pëlqimi për kalim në pronësi në Bashkinë Tropojë ka një sipërfaqe 557 m² ndërtesë dhe 770 m² që ndodhet në pasurinë nr.pasurie 12/173/1 ZK 1347 , Qyteti Bajram Curri , Bashkia Tropoje tek vendi i quajtur "Koj"

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë

3. Ky vendim hyn sipas nenit 55 pika 6 te ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Konceptoi: M.Vatoci

Pranoi; E. Muhametaj

Miratoi: H.Isufaj

Ligjshmeria : B. Haxhiaj

**BASHKIA TROPOJE**

**KRYETARI I BASHKISE**

Rexhë BYBERI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV.KRYETARE E BASHKISË**

Zyra ISLAMAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

Nr. 1931/4 Prot. B.Curri, më 28. _. 2025

Lënda: **Relacion mbi "Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të objektit "Agjencia Koj" e llojit objekt+truall me sipërfaqe 557 m2 ndërtesë dhe 720 m2 truall , nga Ministria e Bbrojtjes në Bashkinë Tropojë , për adaptimin si qendër për kontrollin teknik të automjeteve rrugore"**

Drejtuar : **KËSHILLIT BASHKIA TROPOJË**

Të nderuar Këshilltarë !

Në mbështetje të kompetencave që na jep ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe ligji nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim **projekt-vendimin për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të objektit "Agjencia Koj"**, me qëllim adaptimin e tij si **Qendër për Kontrollin Teknik të Automjeteve Rrugore** në qytetin Bajram Curri.

Objekti në fjalë përbëhet dhe ndodhet në pasurinë me **nr. 12/173/1 ZK 1347**, në vendin e quajtur "Koj", Qyteti Bajram Curri me sipërfaqe 557 m2 ndërtesë dhe 720 m2 truall.

Kjo pronë është aktualisht në administrim të **Ministrisë së Mbrojtjes**, dhe me këtë projekt-vendim synohet që, me pëlqimin e Këshillit Bashkiak, ajo të kalohet në pronësi të **Bashkisë Tropojë**. Kalimi i kësaj prone do të mundësojë krijimin e një strukture publike të domosdoshme për kontrollin teknik të automjeteve, duke përmbushur një nevojë të kahershme të komunitetit dhe të automjeteve që qarkullojnë në këtë zonë.

Ky veprim po bëhet në përputhje me ligjin nr.8743 datë 22.02.2001 *"Për Pronat e Paluajtshme Shtetërore" i ndryshuar, nenit 15 për transferimin e pronës nga një organ shtetëror te një tjetër,* sipas komunikimit me Ministrinë e Mbrotjes.

Bashklidhur gjindet komplet korresponca midis Bashkisë Tropoje me Ministrinë e Mbrotjes për objektin në fjalë

Mbështetur më lart kërkojmë nga ana juaj miratimin e projekt-vendimit **"Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të objektit "Agjencia Koj" e llojit objekt+truall me sipërfaqe 557 m2 ndërtesë dhe 720 m2 truall , nga Ministria e Bbrojtjes në Bashkinë Tropojë , për adaptimin si qendër për kontrollin teknik të automjeteve rrugore"**

Me shumë respekt,

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

| Specialist | Përgjegjës | Drejtor |
|---|---|---|
| Mustaf Vatoci | Egzon Muhametaj | Hazir Isufaj |

Adresa: Qyteti Bajram Curri, Sheshi "Azem Hajdari" Tel:021322373, e-mail: info@tropoje.gov.al, ëeb: tropoje.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE

*Afati i ruajtjes _______ vjet*
*Kopje- 3 (tre)*

*Nr. 1931 Prot.* *B.Curri, me 22. 04. 2025.*

***Lënda:*** *Kërkese per kalimin ne perdorim.*

MINISTRISE SE MBROJTJE

TIRANË

Mbeshtetur ne V.K.M Nr. 397 dt. 01. 06. 2011 "*Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Bajram Curri, te qarkut Kukesit*" si dhe nisur nga nevojat e Bashkisë Tropoje, po ju drejtohemi me këtë kërkesë, lidhur me godinën, Agjensia Koj e cila perdoret per rezerva shteti dhe referuar formularit per inventarizimin e pronave te pluajtshme shteterore ka keto te dhena:
Nr. rendor 157, Zona Kadastrale 1347, Objekt truall, Qyteti Bajram Curri, me permasa 720 $m^2$.

Duke qënë se në rrethin tonë nuk kemi hapësira te tilla për ti përdorur si qender per kontrollin teknik te automjeteve rrugore, do tju luteshim që të shqyrtoni këtë kërkesë, për kalimin e kësaj godinë në përdorim nga Bashkia jonë.

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari"; Tel: 0213 22373; e-mail: info@tropoje.gov.al

Sa sipër jemi në pritje të një përgjigje, duke shpresuar që kërkesa Jonë të merret në konsiseratë nga ana Juaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

Bashkangjitur Formular me te dhenat e godines ne fjale dhe dy foto te objektit.

*Konc.B.Haxhiaj*

KRYETARI I BASHKISË
Rexhe BYBERI

NE MUNGESE DHE ME URDHER
ZV.KRYETARE

Zyra ISLAMAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE -

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari"; Tel: 0213 22373; e-mail: info@tropoje.gov.al

Protokolli
Jane' te B. Curri
= Urbanistika
- Financa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 397, datë 1.6.2011

PËR

## MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BAJRAM CURRI, TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

   Lista me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 173 (njëqind e shatëdhjetë e tre).

# 3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia / Komuna | Bajram Curri | Identifikoi: | Mereme Breçani. Riza Shpati<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) | Specialista |
| | | Supervizoi: | Bedri Haziri<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) | P/Sek.Ekonomik |
| Fusha e perdorimit te Prones | Rezerve shteti | Aprovoi | Isa Memia<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula) | Kryetar i Bashkise |

| Nr. Rend | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Emertesa e Prones Vendndodhja / Shtrirja Gjeografike | Komponentet perberes te Prones | Adresa/Vendndodhja e komponenteve perberes | Permasat e Prones ne m² ose ml | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 157 | 1347 | | Agjensia Koj | Objekt Truall | Qyteti B.Curri | 720. | rezerva shteti | D.P.R.SH. | D.R.U Puke | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E MBROJTJES**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

Nr. 641/1 Prot., Tiranë, më 30 .04.2025

**Lënda:** Në vijim të tuajës Nr.2461 Prot., datë 24.04.2025.

**MINISTRISË SË MBROJTJES**

**Këtu**

**Për dijeni:** **BASHKISË TROPOJË**

**Tropojë**

Në vijim të shkresës Nr.1931 Prot., datë 22.04.2025 të Bashkisë Tropojë "*Mbi kërkesën për kalimin në përdorim*", administruar nga ana juaj Nr.2461 Prot., datë 24.04.2025, e përcjellë për trajtim në DPRMSH sipas shënimeve në kartelën shoqëruese, evidentojmë dhe informojmë si më poshtë vijon:

Me anë të shkresës Nr.1931 Prot., datë 22.04.2025 Bashkia Tropojë ka parashtruar kërkesën për kalimin në përdorim të pronës me emërtesë "*Agjencia Koj*", me vendndodhje Bajram Curri, Tropojë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale e Shtetit te Bashkia Tropojë.

Prona objekt i kërkesës së Bashkisë Tropojë, është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër sipas përcaktimeve të VKM Nr.274, datë 02.05.2019 "*Për disa ndryshime në VKM 413, datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)*", të ndryshuar.

Referuar dokumentacionit teknik (planrilevimit të pronës) si dhe certifikatës së regjistrimit datë 31.10.2022 lëshuar nga ZVASHK Tropojë, DPRMSH-së i njihet e drejta **e administrimit** për pasurinë nr. 12/173/1, ZK. 1347, lloji i pasurisë "truall" me sip. truall 720 m², sip. ndërtesë 557 m².

Për sa më sipër, DPRMSH kërkon saktësimin edhe një herë nga ana e Bashkisë Tropojë të kërkesës së saj referuar akteve ligjore e nënligjore:

- Ligjit Nr.8743, datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme shtetërore*" të ndryshuar, nenit 15, për transferimin e pronës (ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit) nga një organ shtetëror te një tjetër;

- VKM Nr.54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* i ndryshuar, për marrjen me qira ose enfiteozë të pronës, nëpërmjet procedurës së konkurrimit sipas procedurave të sanksionuara në të.

Paraprakisht bashkëlidhur do të gjeni kopje të dokumentacionit tekniko ligjor të pronës.

**Ju falënderojmë për mirëkuptimin,**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Robert HYSENLLARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE

*Afati i ruajtjes _______ vjet*
*Kopje- 3 (tre)*

*Nr. 1931/2 Prot.* *B.Curri, me 05. 05. 2025.*

***Lënda:*** *Saktesim i kerkeses Nr. 1931 dt. 22. 04. 2025 te Bashkise Tropoje.*

**MINISTRISE SE MBROJTJE**

**T I R A N Ë**

**DREJTORISË SE PERGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

**T I R A N Ë**

**DREJTORISË RAJONALE TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

**S H K O D E R**

Në vijim të kërkesës Tonë nr. 1931 Prot. Dt. 22. 04. 2025 "*Kërkesë për kalimin në përdorim*"; shkresës Tuaj Nr. 641/1 Prot. dt. 30. 04. 2025 "*Në vijim të tuajes Nr. 2461.,datë 24. 04. 2025*", protokolluar pranë Bashkisë Tropojë Nr. 1931/1 Prot. dt. 02. 05. 2025 si dhe mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 8743 dt. 22. 02. 2021 "*Për pronat e paluajtshme shtetërore*" të ndryshuar, saktësojmë kërkesën tonë dhe kërkojmë nga ana Juaj:

Transferimin (*ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit*) nga një organ shtetëror te një tjetër dhe konkretisht

- Transferimi i Pasurisë me Nr. 12/173/1, ZK. 1347, lloji pasurisë "truall" me sipërfaqe truall 720 $M^2$, siperfaqe ndërtese 557 $m^2$, nga Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale te Shtetit Shkoder në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Tropojë.

Sa sipër kërkojmë dakortësinë Tuaj për transferimin e ketij objekti në pronësi të Bashkisë Tropojë në mënyrë që të fillojmë procedurat e mëtejshme.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**KRYETARI I BASHKISË**
Rexhe **BYBERI**

**NE MUNGESE DHE ME URDHER**
**ZV.KRYETARE**

**Zyra ISLAMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari"; Tel: 0213 22373; e-mail: info@tropoje.gov.al